



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

MENAXHIMI I RISKUT

KLASIFIKIMI I RISQEVE

Kapitulli 4

Prof. Asoc. Dr. Ibish Mazreku

Ph.D. Fisnik Morina

Risk



MARS, 2018



MENAXHIMI I RISKUT

2

- Lënda: Menaxhimi i Riskut
- Viti III-të, Semestri VI, Departamenti: KF
- Statusi i lëndes: Obligative
- Javët mësimore: 15 (2 orë ligjerata, 2 orë ushtrime)
- Mësimdhënes: Prof. Asoc. Dr. Ibish Mazreku
Ph.D. Fisnik Morina
- Emaili: ibish.mazreku@unhz.eu
fisnik.morina@unhz.eu





KLASIFIKIMI I RISQEVE



- Për shkak të specifikave të riskut, ndarjet janë të mundshme sipas bazave të ndryshme.
- Mirëpo , duhet theksuar se këto tre grupe të riskut që nuk përjashtohen reciprokisht dhe se risqet mundën njëkohësisht të kategorizohen sipas të gjitha këtyre llojeve të klasifikimit.



KLASIFIKIMI I RISQEVE



- Përveç këtij klasifikimi janë të mundura edhe disa klasifikime nga të cilat do përmendim:
 1. Fundamental apo i përgjithshëm i veçantë apo individual,
 2. I ndashëm dhe i pandashëm,
 3. I matshëm dhe i pamatshëm,
 4. I sigurueshem dhe i pasigurueshem,
 5. Risku afarist.



KLASIFIKIMI I RISQEVE

Foto II - 14





RISKU I PASTËR DHE SPEKULATIV



- **Risku i pastër** definohet si situatë ku ekzistojnë vetëm dy mundësi, respektivisht që dëmi të ndodhë apo që mos të ketë fare dëm.
- Ne këtë situatë nuk ka asnjë mundësi që risku të sjellë ndonjë dobi por të vetmet rezultate të mundshme janë rezultatet e padobishme (humbjet) dhe rezultat neutral (nuk ka humbje).
- Ky risk është pasojë e rastit apo stuhisë, e jo të veprimit të vetëdijshëm të individit.



RISKU I PASTËR DHE SPEKULATIV



7

- Në të kundërtën, **risku spekulativ** definohet si situatë në të cilën është e mundur të arrihet ose fitim, apo të vjen deri të humbja apo dëmi.
- Nëse dikush i blenë 200 aksione të rëndomta ai do të arrije fitim nëse çmimi i aksioneve rritet, apo do të ketë humbje nëse çmimet e aksioneve bien.
- Iniciativa afaristë, bastët, lidhja me kusht në gara të kuajve, investimi në patundshmëri, dhe hapja e punës individuale janë disa nga shembujt e riskut spekulativ.
- Në të gjitha këto situata ka mundësi të ketë fitime apo humbje, në të cilin rast ndryshon natyra e pranisë së pasigurisë.



RISKU I PASTËR DHE SPEKULATIV



- Është shumë me rëndësi të bëjmë dallimin në mes të riskut të pastër dhe spekulativ dhe këtë për tre arsye:
- **I pari** është ai, se kompanitë e sigurimeve zakonisht e sigurojnë vetëm riskun e pastër. Me disa përjashtime, risqet spekulative nuk janë ato që sigurohen dhe duhet të aplikohen metoda tjera që ti delet ne fund me këtë risk.
- **E dyta**, ligji i numrave të mëdhenjë mundet shumë më lehtë të zbatohet të risqet e pastra se sa të risqet spekulative. Ligji i numrave të mëdhenjv është i rëndësishëm, sepse ai i mundëson ofruesit të sigurimit që paraprakisht ta planifikoi humbjen.
- **E treta**, është fakt se bashkësia shoqërore mund të përfitoi të risku spekulativ, edhe ne rast se vjen deri të dëmi, por dëmtohet nëse është i pranishëm risku i pastër dhe dëmi ndodh.



RISKU STATIK DHE DINAMIK



- Mënyra e dytë e klasifikim të riskut përfshinë shkallën deri ku ndonjë pasiguri ndryshon gjatë kohës.
- **Risku statik** përfshinë ato risqe që do të ndodhin edhe pse nuk ekzistojnë ndryshime në një shoqëri.
- Ky risk mund të jetë i pastër dhe spekulativ dhe rrjedhë nga mos ndryshueshmëria e shoqërisë e cila gjendet në baraspeshë stabile.
- Kështu që, edhe pse kurrfarë marrëdhënie në shoqëri nga aspekti i prodhimit, çmimeve dhe shijes së konsumatorëve nuk ndryshojnë, disa firma mund të pësojnë humbje për shkak të rreziqeve natyrore apo pandershmërisë së individit.



RISKU STATIK DHE DINAMIK



- Përkundër kësaj, **risqet dinamike** krijohen për shkak të ndryshimeve në shoqëri. Këto risqe gjithashtu mund të jenë të pastër dhe spekulative.
- Shembuj të burimit të risqeve dinamike përfshijnë ndryshimet e çmimeve, shijes së konsumatorëve, të ardhurave dhe vëllimit të prodhimit, teknologjisë kompleksiteti i së cilës gjithnjë e më shumë po rritet dhe ndryshimet në qëndrimet e legjislacionit dhe gjyqeve për pyetje të ndryshme.
- Këto risqe zakonisht janë të pranishme në ndonjë shoqëri gjatë periudhës së gjatë kohore, sepse janë pasojë e përshtatjes ndaj kushteve të dhëna.



RISKU STATIK DHE DINAMIK



- Risqet statike dhe dinamike nuk janë të pavarura; disa risqe më të mëdha dinamike mund të rrisin disa lloje të risqeve statike.
- Shembulli përfshinë pasigurinë e cila është e lidhur me dëmet e ndërlidhura me kushtet kohore. Zakonisht konsiderohet se të gjitha risqet janë statike.
- Mirëpo, faktet e fundit tregojnë se ndotja e ambientit të njeriut e cila është nxitur me rritjen e industrializimit mund të ndikoi në rrethanat globale kohore dhe në këtë mënyrë ky burim i riskut statik po rritët.



RISKU OBJEKTIV DHE SUBJEKTIV



- Nëse risku përcaktohet ekskluzivisht me rrethanat objektive dhe nëse ekziston i pavarur nga sjellja e ndonjë personi, atëherë ai është **risk objektiv**.
- Në sigurime sot ky risk shfrytëzohet që të përshkruhet rreziku që ekziston në ose rreth ndonjë objekti, sikurse që janë blloqet e banimit, ndërtesat industriale, afaristë, komerciale, bujqësore, ndërtesat publike etj.



RISKU OBJEKTIV DHE SUBJEKTIV



- Risku objektiv definohet si shmangie objektive (variacioni) të humbjes së vërtetë nga ajo e pritur.
- Për shembull, të supozojmë se kompania e sigurimit e cila siguron pasuri ka 10.000 banesa të cilat janë të siguruara në afat të gjatë dhe se mesatarisht, 1%, apo 100 banesa digjen çdo vit.
- Ndonjë vit mund të digjen vetëm 90 banesa, ndërsa viteve tjera mund të digjen 110 banesa. Kështu, këtu ekziston një shmangie prej 10 banesave nga numri i pritur prej 100, apo shmangja prej 10%. Variacioni relativ i dëmit të vërtetë në raport me të priturin njihet si risk objektiv.



RISKU OBJEKTIV DHE SUBJEKTIV



- Risku objektiv mundet të matet në mënyrë statistikore përmes ndonjë **mase të dispërzionit**, sikurse qe është **devijimi standard** apo **koeficienti i variacionit**.
- Për shkak të asaj se risku objektiv mund të matet, ai është koncept jashtëzakonisht i dobishëm për kompaninë e sigurimit, apo për menaxherin korporativ të riskut.
- Ashtu si rritet numri i rasteve qe i nënshtrohen një rreziku, kompania e sigurimit mundet shumë më saktë të parasheh raportin e normës së premisë ndaj kërkesave për zhdëmtim të dëmeve të ardhshme, sepse mund të mbështëtet ne ligjin e numrave të mëdhenj.




RISKU OBJEKTIV DHE SUBJEKTIV



- **Risku subjektiv** mundet edhe më tutje të ndahet, ngjashëm sikurse hazardi në **riskun etik** dhe **riskun e vetëkontrollit/vetëdisiplinës**.
- **Risku subjektiv etik** varet nga karakteri, filozofisë jetësore dhe integritetit afariste të ndonjë personi. Ai rrjedh nga gjendja psikike e ndonjë personi.
- **Risku i vetëkontrollit/vetëdisiplinës** përfshinë rreziqet sikurse që është gjendja e vetëdijes që e karakterizon personin të prirur për fatkeqësi, respektivisht rreziqe që i krijon mungesa e përgjegjësisë së personit dhe të cilat janë pasojë e pakujdesit të tij. Këto risqe nuk e kanë konotacionin e mashtrimit.



Foto II - 15





RISKU FUNDAMENTAL APO I PËRGGJITHSHËM DHE I VEQANTË APO RISKU INDIVIDUAL



- **Risku fundamental** është risk që ka ndikim në tërë ekonominë apo në numrin madh të personave apo grupeve në kuadër të asaj ekonomie.
- Këto janë zakonisht ato risqe të cilët janë pasojë e fenomeneve shoqërore apo politike, edhe pse mund të paraqiten edhe si pasojë e fenomeneve fizike.
- Shembujt përfshijnë inflacionin e lartë, papunësinë ciklike dhe luftërat, sepse ato ndikojnë në numrin e madhe të individëve.
- Risku nga fatkeqësitë natyrore është risku i dytë i rëndësishëm fundamental. Tornadot, tërmetët, vërshimet dhe zjarret në pyje munden që si pasojë të kenë dëme në pasuri të cilat mund të kushtojnë me miliarda euro si dhe humbje të numrit të madh të jetëve njerëzore.



RISKU FUNDAMENTAL APO I PËRGGJITHSHËM DHE I VEQANTË APO RISKU INDIVIDUAL



- Kohëve të fundit po paraqitet një formë e re e riskut fundamental, e ky është risku nga sulmet tërroristë.
- Shumë vende tanimë e kanë shijuar këtë lloje të rrezikut i cili dukshëm po rritet çdo ditë, e rezultat i të cilit janë shumë viktima njerëzore.
- Sulmi terrorist që është krye në SHBA në muajin shtator 2001 ka pasur për pasojë shkatërrimin e katër avionëve komercial, shkatërrimin e plotë të dy kullave të Qendrës Botërore të Tregtisë, rrëzimin e pjeshëm të ndërtesës së Pentagonit dhe me mijëra viktima në njerëz. Dëmi i vlerësuar ka qenë rreth 40 miliard dollarë amerikan. .

Tabela II – 6 dhjete katastrofat me te shtrenjta te siguruarra

Nr.	Muaji/Viti	Katastrofa	Shuma e sigurimit ne miliona \$
			----- Ne momentin e rrodhjes
1.	Shtator 2001	Qendra tregtare botërore, Nju Jork 2001, sulm terrorist	20.500
2.	Gusht 1992	Stuhia Andrew: fryma, vërshimet, tornado	15.500
3.	Janar 1994	Termeti: Northridge, Kaliforni	12.500
4.	Shtator 1989	Stuhia Hugo; fryma, vërshime, tornado	4.195
5.	Shtator 1998	Stuhia Georges	2.900
6.	Qershor 2001	Erërat Tropikale Alison	2.500
7.	Tetor 1995	Stuhia Opal	2.100
8.	Shtator 1999	Stuhia Floyd	1.960
9.	Mars 1993	Stuhia dimërore ne 20 vende	1.750
10.	Tetor 1991	Zjarri ne Okland, Kaliforni	1.700



RISQET E SHPËRNDARA DHE RISQET E PASHPËRNDARA



- Risku është **i ndashëm** nëse ai mund të zvogëlohet përmes marrëveshjes për bashkësi apo për pjesëmarrje.
- **I pandashëm** është ai risk të i cili marrëveshjet për bashkësi nuk janë efikase për zvogëlimin e riskut për anëtarët e atij polli.
- Për shembull, marrëveshjet për bashkësi do të ishin joefikase për rrezikun e krizës ekonomike botërore, sepse risku ndikon në të gjithë pjesëmarrësit në mënyrë të njëjtë dhe në kohë të njëjtë.



RISQET E SHPËRNDARA DHE RISQET E PASHPËRNDARA



- Dallimi në mes të këtyre dy risqeve është e rëndësishme për menaxhimin e riskut, sepse ajo ndikon në mundësinë e shfrytëzimit të marrëveshjes për shpërndarjen e riskut.
- Si ilustrim mund të na shërben shembulli në vijim. Një pronar shtëpie është ballafaquar me mundësi dëmi nga pasojat e vërshimeve.
- Ku risk mund të zvogëlohet përmes lidhjes së marrëveshjes për shpërndarje të riskut me pronaret tjerë të shtëpive në vendbanimin e njëjtë, por efikasiteti i marrëveshjes së tillë qëndron nëse zvogëlohet mundësia që vërshimi në të njëjtën kohë të dëmtojë me shumë shtëpi në këtë pullë.



RISQET E MATSHME DHE TË PAMATSHME



- **Risqe të matshme** janë ato që mund të maten në nivelin e portfolios mjaft të madhe dhe të balancuar të sigurimeve. Kjo do të thotë se këto rreziqe mund të matën ne kuadër të ndonjë bashkësie, e jo vetëm të individit.
- **Të pamatshme** janë ato rreziqe të cilat nuk mund të maten në asnjë nivel. Këto zakonisht janë ato rreziqe të cilat janë të lidhura me lëvizjet në treg, sikurse që janë çmimet e lëndëve të para strategjike etj. Këto rreziqe nuk mund të barten në shoqëri të sigurimeve.



- Edhe pse teorikisht është e mundur që të sigurohen të gjitha rreziqet potenciale, megjithatë disa prej tyre nuk mund të sigurohen për shkaqe ligjore, komerciale dhe morale, dhe ata quhen risqe të pa sigurueshme.
- Një nga risqet e tilla është risku i papunësisë, sepse norma e pa punësisë varron varësisht prej profesionit, moshës, gjinisë, arsimimit, statusi familjare, qyteti, shteti dhe varet edhe nga shumë faktorë të tjerë duke përfshi edhe programet qeveritare dhe politiken ekonomike.
- Zakonisht sigurohen vetëm risqet e pastra, por nuk mund të sigurohet edhe secili risk i pastër.

Ju Faleminderit për vëmendje !

24

□ SUKSESE !

